



Republika e Kosovës-Republic of Kosova
Ndërmarrja Publike Lokale
“PASTRIMI”SH.A
Hani Elezit



01/Nr.1176/2024

Data:08.02.2024

Data:	05.01.2024
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit
PËRMES:	Kryesues/e i Komisionit të Aksionarëve – znj.Sevime Bajrami
NGA:	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave - NPL“PASTRIMI” SH.A
LËNDA:	Informatë mbi raportin vjetor Janar – Dhjetor /2023 – Npl”Pastrimi” Sh.a

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Me anë të këtij raporti, ju përcjellim informatën për periudhën Janar - Dhjetor/2023 për Ndërmarrjen Publike Lokale të Mbeturinave - Npl“Pastrimi”Sh.a.

Informatë mbi raportin vjetor Janar - Dhjetor / 2023 të NPL”PASTRIMI” SH.A

Me respekt.

RAPORTI VJETOR JANAR –DHJETOR / 2023, I NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE TË MBETURINAVE - NPL"PASTRIMI" SH.A

Ky raport është përgatitur për periudhën Janar – Dhjetor / 2023, në bazë të ligjit për Ndërmarrjet Publike - Ligjit Nr.03/L-087, të nenit 31 dhe nenit 14, paragrafit 14.2 dhe Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Pastrimi” Sh.a. Ndërmarrja Publike Lokale – NPL “PASTRIMI” SH.A, bënë menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunësse Hanit të Elezit, ku përfshihen me shërbim të gjitha lokalitetet e komunës.

Ndërmarrja Publike Lokale – Npl”Pastrimi”Sh.a, në total kanë punëtor (23), ku prej tyre shtatëmbëdhjetë punëtor(17) janë të rregullt dhe pesë (6) punëtor me kontratë për “kohë të caktuar”si vijon:-

- 1 Kryeshef Ekzekutiv
- 1 Sekretar i Ndërmarrjes /Këshilltar
- 1 Zyrtar i Lartë Financiar /Thesarë
- 1 Arkëtar/e
- 1 Zyrtar i Prokurimit
- 1 Inkasant
- 2 Shofer
- 4 Punëtor teknik
- 11 Pastrues (Grumbullues të mbeturinave)

Sa i përket periudhës së muajve Janar – Dhjetor/2023 ka qenë një periudhë e angazhuar dhe me shumë aktivitete të ndryshme nga punëtorët e ndërmarrjes publike “Pastrimi”Sh.a, punë të cilat janë kryer në pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në qytet dhe në fshatra përreth. Gjatë kësaj periudhe janë kryer disa punë si:- pastrimi i varrezave të dëshmorëve në Pustenic, pastrimi i rrugës në Pustenic, pastrimi i përroit në Lagjen e Re, pastrimi i përroit në fsh. Seçishtë, pastrimi i rrugës në fshatin Laç, pastrimi i magjistrales “Adem Jashari” – Uji i Thartë, pastrimi i rrugës në Seçishtë – Krivenik, pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave të qytetit në Rrafshë, pastrimi dhe mirëmbajtja e parkut të qytetit “Isa Berisha”, pastrimi i rrugës në fsh. Gorancë, pastrimi dhe mirëmbajtja e parkut të eksodit “Blacca 99”, mbjellja e fidanëve të llojit pishë në kodrën e Shullanit në fsh. Seçishtëaktivitete të cilat i kemi publikuar në ueb faqe zyrtare të ndërmarrjes publike lokale - Pastrimi.

Në muajin mars tre punëtor e kanë ndërprerë kontratën e punës me vullnetin e plotë të tyre me Npl”Pastrimi” Sh.a, për arsye të punësimit të tyre në një sektor tjetër publik, ndërsa një punëtor tjetër Fitim Daci me vullnetin e tij të plotë në muajin maj e ka shkëputur kontratën e tij me punëdhënësin - NPL-në, për arsye të punësimit të tij në një sektor tjetër privat të ndërtimitarisë.

Në muajin Prill me iniciativën e Bordit të Drejtorëve të Npl-së, Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit ka ndryshuar rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, rrjedhimisht ndryshimin e tarifës së shërbimit të mbeturinave nga muaji Qershor 2023 dhe duke filluar nga ky muaj klientët janë faturuar me çmime të ngritura.

Gjatë vitit 2023 Ndërmarrja Publike Lokale “Pastrimi”, dhe Zyra e Punësimit - dega në Hani i Elezit kanë nënshkruar disa marrëveshje mirëkuptimi për pranimin e pesë punëtorëve me kontratë pune për kohë të caktuar në afat gjashtë (6) muajtë cilët i paguan Zyra e Punësimit në lartësi prej 70% të pagës mujore, ndërsapjesën tjetër e paguan NPL-ja, ndërsa një punëtor tjetër me kontratë punepër kohë të caktuar në afat gjashtë (6) muaj të cilin e paguan Npl “Pastrimi”Sh.a.

Në muajin gusht ndërmarrja publike lokale “Pastrimi” ka hapur një konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës në pozitën e punës “Grumbullues i mbeturinave”, ku në këtë pozitë kanë aplikuar tre aplikant dhe pas kryerjes së procedurave të konkursit është përzgjedhur kandidati i cili ka qenë më i suksesshmi në pikët e arritura në testin me shkrim dhe gjatë intervistës.

Gjatë muajit nëntor është vazhduar edhe për një vit marrëveshja me komunën për “shërbimet e mirëmbajtjes së rrugëve lokale gjatë sezonit veror dhe dimëror dhe punëve tjera të specifikuar në këtë marrëveshje”, gjithashtu është vazhduar për një vit aneks marrëveshja për punëtorët teknik me Komunën e Hanit të Elezit -DKA.

Në muajin nëntor Bordi i Drejtorëve me iniciativën e kryeshefit ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Lokale “Pastrimi” morri vendim për ngritjen e pagave për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes publike lokale me nga pesëdhjetë (50) euro bruto në muaj, duke filluar nga muaji Dhjetor 2023.

Lista e punëtorëve të NPL-së, pozita e vendit të punës dhe paga e tyre si vijon:-

Nr.	Pozita	Nr. Punëtorëve	Paga Bruto
1	Kryeshefi Ekzekutiv	1	682.5
2	Zyrtari i Larte Financiar - Thesarë	1	423.85
3	Sekretar i Ndërmarrjes - Këshilltar	1	423.85
4	Arkëtar/e	1	423.85
5	Shofer	1	362.5
6	Shofer – mbykqyres i punëtorve në teren	1	423.85
7	Inkasant	1	362.5
8	Grumbullues i mbeturinave	11	303.01
9	Punëtor teknik	4	303.01
10	Zyrtar i prokurimit	1	120
	TOTALI I STAFIT TË NPL-SË	23	

Gjatë periudhës së muajve Janar – Dhjetor /2023, janë mbajtur dymbëdhjetë (12) mbledhje të rregullta me Bordin e Drejtorëve të Npl "Pastrimi" Sh.a.

Çmimet e kontratave janë:-

- Kontratë familjare **6.50 €**, në muaj,
- Kontratë e mesme – biznes **10.40 €**, në muaj,
- Kontratë me zbrazje – biznes **16.90 €**, për çdo zbrazje të kontenjerit **1100L**.

Gjatë periudhës së muajve Janar– Dhjetor /2023, janë nënshkruar disa kontrata me klient të rinjë të Npl "Pastrimi" Sh.a, ato janë:-

- Kontratë familjare **22**,
- Kontratë biznesore **8**,
- Institucionale **0**.

Totali i kontratave të nënshkruara nga viti 2017 –Dhjetor / 2023 janë si vijon:-

- **Ekonomitë familjare ----- 1488**
- **Kontratë biznesore ----- 103**
- **Kontratë institucionale ----- 10**
- **Totali i kontratave ----- 1601**

1. Hyrje

Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të nenit 14, paragrafët 14.2 si dhe statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale.

Ky raport përmban një përmbledhje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore të kompanisë së mbeturinave përgjatë periudhës Janar – Shtator 2023. Raporti pasqyron të hyrat e kompanisë, si dhe krahasimet me periudhë paraprake.

1.1. Performanca e të hyrave nga shërbimet

Të hyrat nga shërbimet kanë arritur vlerën 196,018.41 euro duke shënuar trende rritëse me 19,513.63 euro më shumë krahasuar me të hyrat e vitit 2022.

Performanca e shpenzimeve të kompanisë

Shpenzimet e kompanisë kanë arritur vlerën prej 194,994.84 euro duke shënuar një rritje prej 11,071.45 euro më shumë krahasuar me vitin paraprak.

- **Shpenzimet për paga dhe mëditje** shënuan vlerën e 116,060.26 € duke shënuar një rënie prej 3,871.76 € krahasuar me vitin 2022.
- **Shpenzimet në tatime** shënuan vlerën e 8,214.01 euro duke shënuar një rritje prej 7,014.01 euro më shumë krahasuar me vitin 2022.
- **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 73,720.57 duke shënuar një rritje prej 7,236.57 € krahasuar me vitin 2022.

2. TË HYRAT E KOMPANISË

	TE HYRAT	2022	2023	Krahasimi
1	Të hyrat nga Shërbimet	180,090.74	196,018.41	15,927.67
2	Te hyra tjera	104.90	2,772.00	2,667.10
3	Paraja në bankë	1,127.60	2,046.46	918.86
	TOTALI	181,323.24	200,836.87	19,513.63

3 SHPENZIMET E KOMPANIS

3.1 PAGA DHE MEDITJE

A	PAGAT DHE MEDITJET	2022	2023	Krahasimi
1	PAGAT NETO + SHUJTA	99,055.24	101,066.82	2,011.58
2	KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	4,780.20	5,372.68	592.48
3	KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	4,780.20	5,372.68	592.48
4	TATIMI NE BURIM	3,572.86	4,248.08	675.22
	TOTALI	112,188.50	116,060.26	3,871.76

3.2 TATIMET

B	TATIMET	2022	2023	Krahasimi
1	TVSH-ja 8%	-	7,164.01	7,164.01
2	KESTET TREMUJORE (ATK)	1,200.00	1,050.00	(150.00)
3	TATIMI VJETOR MBI KORPORATA			-
	TOTALI	1,200.00	8,214.01	7,014.01

3.3 MALLRA DHE SHERBIME

C	MALLRA DHE SHËRBIME	2022	2023	Krahasimi
1	Shpenzime për karburant	26,349.26	24,524.76	(1,824.50)
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	12,175.83	13,975.90	1,800.07
3	Shpenzimet për internet	99.90	150.00	50.10
4	Shpenzimet e Mirëmbajtjes se Mjeteve	10,447.22	13,784.10	3,336.88
5	Shpenzime për Softuer Kompjuterik	400.00	1,180.00	780.00
6	Shpenzime për zyre dhe administrative	378.00	3,145.24	2,767.24
7	Shpenzime për zyre pajisje dhemjete pune	10,569.55	6,847.14	(3,722.41)
8	Shpenzime për trajnime	684.00	790.00	106.00
9	Shpenzimet e Reprerentacionit	2,126.00	1,658.10	(467.90)
10	Shpenzimet e Sigurimit	2,230.54	1,343.48	(887.06)
11	Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	274.00	1,161.95	887.95
12	Provizione Bankare NLB BANK	139.30	117.90	(21.40)
13	Çertifikata për shofer kamioni	120.00	80.00	(40.00)
14	Çertifikatashëndetsore	64.00	68.00	4.00
15	Licence	18.08	500.00	481.92
16	Uniforma Pune		3,738.00	3,738.00
17	Shpenzimet e rrym	408.67	656.00	247.33
	TOTALI	66,484.35	73,720.57	7,236.22

3.4 TOTALI I TE HYRAVE DHE SHPENZIMEVE

	TE HYRAT	2022	2023	Krahasimi
1	Të hyrat nga Shërbimet	180,090.74	196,018.41	15,927.67
2	Te hyra tjera (Ministria e Punes)	104.90	2,772.00	2,667.10
3	Paraja në bankë	1,127.60	2,046.46	918.86
	TOTALI	181,323.24	200,836.87	19,513.63
	SHPENZIMET			
	Shpenzime Tjera A+B+C+D+E	179,872.85	197,994.84	18,121.99
	Fitimi/Humbja	1,450.39	2,842.03	1,391.64